

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR



INFORMACIONE

PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUJIT MARS

Komisioni Teknik i KOKSH - Mbledhja I

Presidenti i KOKSH pret Boksierin Qato

Komisioni i Kualifikimit i KOKSH

Komisioni „ Femra & Sporti “

Këshilli i Arbitrimit Sportiv (KAS)

ICMG “ALMERIA 2005”

Bursa Mesdhetare / Mundja dhe Boksi

KOKSH – UN & Partnerët

Dita Olimpikë e Vrapimit Kavaje

KS Pogradeci - 90 Vjet

Komisioni Teknik – Mbledhja II

Komisionit Sporti për të Gjithë

Informacione nga Federatat



“ Almeria 2005”
Mbledhje e Komisionit Teknik



Mbledhje e Komisionit
“Femra dhe Sporti”

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Rruga: “Muhamet Gjollësja” - Tel. +355 235249/240602 - Fax. +355 240565

E-mail: secretariat@nocalbania.org.al - www.nocalbania.org.al



05.03.05 – Komisioni Teknik i KOKSH

Zhvilloi mbledhjen e parë të këtij komisioni për mandatin 2005-2008. Prezantimi i anëtarëve të komisionit ishte pika e parë e rendit të ditës. Anëtarët e këtij komisioni, u prezantuan në vijim të pikës së parë të rendit të ditës, të cilën e drejtoi z. Fidle Ylli, Kryetar i Komisionit.

Objekti ku u përqëndrua tematika e mbledhjes, ishte pjesmarrja e Shqipërisë në Lojrat Mesdhetare « *Almeria 2005* » dhe përgatitjet dhe problematikat që shoqërojnë procedurat e pjesëmarrjes në Lojrat Mesdhetare.

Presidenti i KOKSH Hysen Domi, Drejtori i Sportit i MKRS dhe përfaqësues të tjerë të saj, si dhe Drejtori i QKSH morën pjesë në këtë mbledhje, e cila u zhvillua me praninë e Presidentëve dhe Sekretarëve të përgjithshëm të federatave sportive. Kjo mbledhje u pasqyrua gjërësisht nga Media TV dhe e shkruar.

10.03.05 Presidenti pret Boksierin Qato

Në mjediset e KOKSH, pas suksesit të mbërritur në qytetin e tij të lindjes, dhe fitores së kurorezuar në Atdheun e tij, Presidenti i KOKSH përshëndet Boksierin Kreshnik Qato për fitoren ndaj boksierit Ukrainas. Kjo fitore, e boksierit profesionist Shqiptarit i cili garon gjithnjë me shqiponjën e qëndisur në uniformën e tij, këtë radhë një fitore e bukur ndaj Ukrainasin Mogamedov në peshën super të Mesme, Presidenti Domi dhe Sekretari i Përgjithshëm Bello i KOKSH në pritjen e tyre, shprehën vlerësimin për këtë fitore domethënëse, si dhe rëndësinë e shumanshme të sportit si një ambasador i Shqipërisë në Botë. Kreshnik Qato tashmë ka rolin e tij në këtë imazh të vendit të tij.

**15.03.05 Komisioni i Kualifikimit i KOKSH**

Një tjetër komision i KOKSH, është edhe ai i Kualifikimit, komision i cili është i ri në strukturën e organizmit olimpiq Shqiptar përmandatin 2005-2008. Në mbledhjen e parë të tij, Sekretari i Përgjithshëm Stavri Bello prezantoi misionin dhe detyrat e komisionit.



Në këtë mbledhje të parë, komisioni diskutoi në mënyrë analitike për strategjinë e kualifikimit bazuar mbi Programin Botëror 4-vjeçar të Solidaritetit Olimpik 2005-2008 dhe strukturën e aplikimeve në këtë program.

15.03.05 – Komisioni “Femra & Sporti”

Në ambjentet e KOKSH u zhvillua mbledhja e parë e Komisionit F & Sp. për 2005-2008. Mbledhjen e hapi kryetarja e këtij komisioni znj. Ela Tase. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH, në këtë mbledhje bëri një hyrje për punën që pritet dhe do të ndërtojë Komisioni Femra dhe Sporti, i cili pritet të bashkëpunojë me organizata të tjera simotra. (Siç ishte rasti i Tryezës së Rrumbullakët me Komitetin për Mundësi të Barabarta). Organizimi i Konferencës së III Kombëtare « Femra dhe Sporti » si dhe angazhime në aktivitete që promovojnë pjesëmarrjen e femrës në sport dhe në vendimmarrje, pritet të t jenë fokusi i punës së komisionit.



15.03.05 Këshilli i Arbitrimit Sportiv (KAS)

Këshilli i Arbitrimit Sportiv u mbledh më dt. 15 Mars ku shqyrtoi ankesën e paraqitur nga z. Pirro Ruvina lidhur me kandidimin e tij në Asamblenë Zgjedhore të Federatës Shqiptare të Atletikës e cila u mbajt më 16-të Dhjetor 2004 Vendimi i KAS, orienton realizimin e asamblesë së FSHA për rizgjedhjen e Kryesisë së saj.

**18-20.03.05 ICMG "ALMERIA 2005"**

Sekretari i përgjithshëm i KOKSH, anëtar i Komisionit Teknik të Komitetit Ndërkombëtar të Lojrave Mesdhetare (ICMG) në Almeria të Spanjës mori pjesë në takimet e organizuara me Komitetin Ekzekutiv të ICMG dhe me Komisionerët e Lojrave Mesdhetare. Çështjet e diskutuara në këto mbledhje përfshinë problemet në lidhje me infrastrukturën, ambjentet, shërbimet, komunikimi, teknologjia, promovimi në massmedia dhe sponsorizimi. Në këtë mbledhje u diskutua gjithashtu regjistrimi paraprak i pjesëmarrësve në Lojrat Mesdhetare "Almeria 2005".

23.03.05 Bursa Mesdhetare / Mundje

KOKSH - ICMG në bashkëpunimin e tyre, në kuadër të Bursave Mesdhetare mundësuan që Sportisti Gentian Geraj në stilin Mundje e Lirë, të niset për në qytetin e Samsunit (Turqi) ku do të marrë pjesë në kampin stërvitor që Federata Turke e Mundjes organizon në kuadër të përgatitjeve për Lojrat Mesdhetare, ku është i grumbulluar Ekipi Kombëtar i Turqisë mundje stil i lirë. E ka përfutur këtë bursë edhe boksieri Klajdi Xhaja i cili do të niset në 7 Prill 2005 në qytetin e Stambollit për të marrë pjesë në kampin stërvitor që do të zhvillojë Federata Turke e Boksit me ekipin kombëtar.

24.03.05 KOKSH – UN & Partnerët

Në kuadër të programit të Përbashkët për Rininë dhe '2005-Viti i Edukimit Fizik dhe Sportit', KOKSH, agjensitë e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe partnerët e tjerë qeveritarë zhvilluan takimin e radhës konsultativ në vijim të përgatitjeve për lancimin e përbashkët. Sekretari i Përgjithshëm Stavri Bello, dhe koordinatori i këtij projekti Elda Gjoka asistuan në përgatitjet e draftit përfundimtar të këtij projekti i cili do të lancohet në mënyrë të përbashkët gjatë muajit Prill 2005.

24.03.05 Dita Olimpike e Vrapimit Kavaje

Në kuadër të promovimit të vitit 2005 si viti i edukimit dhe zhvillimit nëpërmjet sportit, në stadiumin Besa të qytetit të Kavajës u organizua veprimtaria Olimpike « Dita Olimpike e Vrapimit », iniciativë kjo e Shoqatës « ILIRIA » të emigrantëve shqiptarë në Trieste të Italisë, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar. Nxënësit e shkollave 9 vjeçare të qytetit të Kavajës dhe e ftuara speciale shkolla e komunës Luz i Vogël ishin protagonistët kryesorë të këtij aktiviteti masiv. U zhvilluan gara të dryshme atletikore për vajza dhe djem, lojra të ndryshme popullore, gara me biçikleta me fëmijët e kopshtit, etj. Aktiviteti u ndërthur me pjesë artistike si këngë, valle popullore të përgatitur nga Qendra Kulturore e Fëmijëve Kavajë.



Kupa, medalje dhe çertifikata u ndanë për fituesit dhe pjesëmarrësit në aktivitetet dhe dhurata të veçanta u shpërndanë për persona me aftësi të kufizuara të përgatitura nga Shoqata Iliria dhe KOKSH. Në aktivitetet u nderuan edhe figura të shquara të sportit të qytetit të Kavajës që kanë dhënë kontribut në Lëvizjen Sportive dhe atë Olimpike. Organizimi i aktivitetit ishte nën kujdesin e Bashkisë së qytetit të Kavajës, Qendrës Kulturore, Drejtorisë Arsimore të rrethit, QK. të Fëmijëve, SK.Besa dhe Drejtorive të shkollave 9 vjeçare.

COE - Seminari i Komitetit Olimpik European në Tiranë

Në kuadër të Seminarit të 26 të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Shefave të Misionit të Komiteteve Olimpikë European i cili do të zhvillohet në Shqipëri në datat 6-7 Maj, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello, ka realizuar takimet që vijojnë punën përgatitore të KOKSH për organizimin me sukses të këtij Seminari. Thelbi i takimeve ka qenë kompleks dhe i larmishëm në përmbajtjen e tyre, ku ka të bëjë me planifikimin dhe logjistikën e një projekti të tillë siç është ky Seminar..., ku priten të vijnë në Shqipëri 200 pjesmarrës. “Sheraton -Hotel & Touers” dhe “Rogner Europa Park” janë hotelet zyrtar të aktivitetit.

27.03.05 KS Pogradeci - 90 Vjet

Në Hotel Turizmi në qytetin e Pogradecit u zhvillua ceremonia e 90 vjetorit të Krijimit të Klubit Sportiv Pogradeci. Organizimi i këtij përvjetori ishte nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë Pogradec, nën Prefektit të qarkut dhe Klubit Shumësportësh Pogradec. Për të nderuar këtë ceremoni kishin ishin të pranishëm përfaqësuesi i KOKSH z. Kliton Muça, Presidenti i FSHV z. Gjergj Liqejza dhe Sekretari i Përgjithshëm i saj z. Leonard Tase. Çmime, Vlerësime dhe Dedikime mirnjohjeje u shpërndanë për të gjithë ata që kanë kontribuar në sportin pogradecar. KOKSH ka dhuruar Dedikime disa drejtuesve dhe sportistëve vlerësim për kontributin e dhënë në Lëvizjen Sportive dhe atë Olimpikë. Pjesë e kësaj ceremonie ishte edhe ekspozita ku tregoheshin aktivitetet e sportit Pogradecar në vite

31.03.05 Komisioni Teknik – Mbledhje II

Në ambjentet e KOKSH u zhvillua mbledhja e dytë për nga radha e Komisionit Teknik të KOKSH nën drejtimin e Kryetarit Fidel Ylli.



Objekt i mbledhjes ishin:

- Përgatitjet për Lojrat Mesdhetare « Almeria 2005 » dhe rezultatet e sportistëve kandidatë
- Përgatitjet për Festivalin Olimpik Rinor European « Lignano 2005 » dhe rezultatet e sportistëve kandidatë
- Bursat e Talenteve të Reja

Në praninë e Presidentit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të KOKSH, në mbledhje morën pjesë edhe Drejtori i Sportit në MKRS, Sekretarët e Përgjithshëm të Federatave sportive, etj.

31.03.05 Komisionit Sporti për të Gjithë

Mbledhja e parë e Komisionit Sporti për të Gjithë për 4-vjeçarën 2005-2008. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello i cili asistoi në këtë mbledhje të parë të këtij Komisioni bëri edhe prezantimin detyrave dhe objektivave të komisionit.

Anëtarët e Komisionit diskutuan mbi :

- Riorganizimin e Komisionit « Sporti për të Gjithë »
- Njohja me Kartën Europiane të « Sporti për të Gjithë »
- Aplikimi për aktivitetin e « Sporti për të Gjithë » nën patronazhin e CIO.



NGA FEDERATAT:

22-23 Mars Kampionati Kombëtar i peshëngritjes për të Rinj.

Në datat 22-23 Mars 2005 u zhvillua Kampionati Kombëtar i peshëngritjes për të Rinj në qytetin e Elbasanit. Në aktivitet u përfaqësuan 12 ekipe për meshkuj me 58 sportistë dhe 2 ekipe për femra me 6 sportiste. Për femra ekipi kampion u shpall Juvenilja dhe Fetie Kasaj u shpall sportistja më e mirë në bazë të pikëve të marra. Ndërsa Ekipi Kampion për djem u shpall Elbasani dhe sportisti më i mirë Endri Haxhihyseni.

C
I
T
I
U
S

A
L
T
I
U
S

F
O
R
T
I
U
S